



## TERMA REFERENCE SHOFER

Shëndet për të Gjithë është një Projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim i zbatuar nga Instituti Zviceran i Shëndetit Publik dhe Mjekësisë Tropikale në Bazel, në bashkëpunim me Qendrën HAP në Shqipëri. Qëllimi i projektit është që popullsia shqiptare të përfitojë nga shëndetësia më e mirë falë shërbimeve të përmirësuara të Kujdesit Shëndetësor Parësor.

### Qëllimi i pozicionit:

Vendi i punës së shoferit është një pozicion pranë Qendrës HAP. Shoferi do të mbështesë ekipin e projektit HAP në zbatim të përgjigjesive dhe kompetencave të kërkuara më poshtë:

### Detyrat dhe Përgjegjësitë

Shoferi do të ofrojë një shërbim të besueshëm dhe të sigurt në drejtimin e automjetit duke garantuar përgjegjshmëri të lartë gjatë ofrimit të këtij shërbimi. Detyrat më në detaj të drejtuesit të automjetit do të jenë si më poshtë:

- Garanton drejtimin e besueshëm dhe të sigurt të automjetit të caktuar nga projekti për transportin e personelit të autorizuar të Qendrës HAP dhe ekspertëve (kur kërkohet); zbaton në mënyrë të përpiktë të gjithë rregullat në lidhje me përdorimin dhe menaxhimin e automjeteve të HAP siç parashikohet nga Manuali Operacional i Qendrës HAP;
- Këshillon dhe mban plotësisht përgjegjësinë për zgjedhjen e itinerarit më optimal të rrugës për në/nga destinacioni i udhëtimit; të jetë i përgatitur të udhëtojë në zonat e veprimt të projektit kur kërkohet në periudha të gjata larg vendit fiks të punës si dhe të punojë jashtë orarit normal të punës nëse do të jetë e nevojshme;
- Të garantojë parkimin e automjetit në vend-parkime të sigurta dhe të autorizuara;
- Siguron mirëmbajtjen e përditshme të automjetit të caktuar duke përfshirë kontrollin e motorit, baterinë, nivelin e vajit, ujit dhe elektroliteve, frenat, kandelet, konsumin e karburantit, presionin e gomave etj. Merr masat për të dërguar makinën për riparime të mëdha (nëse ka nevojë), ndjek në kohë ndërrimin e nevojshëm të vajit dhe filtrave, siguron që makina të jetë e larë etj.
- Siguron shkurtime të shpenzimeve nëpërmjet përdorimit të duhur të automjetit dhe mbajtjes së saktë të regjistrave ditor të automjetit;
- Siguron disponueshmërinë e gjithë dokumentacionit të nevojshëm të automjetit si siguracioni, kolaudimi, pagesat e taksave, regjistrat e automjetit, kilometrazhin ditor, konsumin e karburantit, kutinë e ndihmës së shpejtë, pjesë të nevojshme këmbimi në automjetin e caktuar; garanton ndjekjen e të gjitha hapave dhe masave të nevojshme në rast aksidenti sipas legjislacionit në fuqi;
- Mbledh dhe/ose dorëzon postën, dokumenta dhe/ose materiale të tjera si dhe kryen çdo detyrë që i caktohet nga mbikqyrësi.

### Kompetenca

- Njohuri të rregullave dhe rregulloreve të trafikut dhe aftësi në riparime të vogla të automjetit;
- Njohuri të mira dhe praktikë në mirëmbajtjen e regjistrave ditor të automjetit në zbatim të rregullave të Qendrës HAP;
- Aftësi për qasje pozitive ndaj punës, me energji dhe qëndrim konstruktiv;
- Aftësi për të ruajtur qetësinë, kontrollin dhe garantuar një gjendje të mirë emocionale edhe në situata stresuese;
- Aftësi të shkëlqyera ndërpersonale/komunikuese.



### **Aftësi dhe kompetenca të preferuara**

- Punë të mëparshme në organizata ndërkombëtare;
- Njohuri të gjuhës angleze.

### **Aftësi dhe eksperiencia të kërkuara**

Shkollimi:

- Të ketë përfunduar arsimin e mesëm;

Eksperiencia:

- Të paktën 5 (pesë) vite eksperiencë në drejtim automjeti si shofer profesionist;

### **Çertifikata profesionale**

- Leje të vlefshme të drejtimit të automjetit (kategoria B)

### **Kohëzgjatja e kontratës**

- 10 muaj me mundësi zgjatje

### **Aplikantët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e mëposhtme:**

- 1- CV-në e përditësuar, me të paktën 5 (pesë) vite eksperiencë në drejtim automjeti si shofer profesionist
- 2- Kopje e lejes së drejtimit të vlefshme dhe diplomën përkatëse (diplomë e shkollës së mesme dhe/ose diplomë universiteti)
- 3- Dy referenca të firmosura të cilat duhet të përfshijnë emrin, adresën e e-mailit dhe numrin e telefonit të punëdhënësit.

Dokumentat e mësipërme duhet të dorëzohen brenda datës **10 Maj 2022, ora 16:00**, në një zarf të mbyllur mbi të cilin të jetë shënuar qartë **“Njoftim për vend pune – Shofer”** në adresën e mëposhtme:

### **HAP Centre**

Rruga Themistokli Gërmenji

Pallati Helios, Kati II, Ap.5

Tirane, Shqipëri

**Shënim: Kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen brenda datës 20 Maj 2022 në lidhje me hapat e mëtejshëm të procesit të rekrutimit.**